



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 103

Tiranë – E hënë, 13 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 1.6.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për realizimin e projektit “Rindërtimi i banesës ku u ngrit flamuri në Korçë”.....	5769
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 14, datë 10.5.2016	Për ofrimin e shërbimit të emergjencës në institucionet e përkujdesjt shoqëror të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit publik që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidencial për fëmijët në nevojë.....	5769
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 67, datë 1.6.2016	Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare”.....	5772
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 63, datë 27.5.2016	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të licencuarve që mbartin detyrimin e shërbimit publik”.....	5776
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 27.5.2016	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit.....	5777
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 65, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për vendosjen e detyrimit të shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri”.....	5777
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 66, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.....	5778

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 67, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Rregullores mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”.....	5778
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”.....	5778
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016, për kompaninë OST sh.a.....	5779
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016, për kompaninë OSHEE sh.a.....	5780
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të KESH sh.a., për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016.....	5780
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a., për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga furnizuesi i shërbimit universal për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016.....	5781
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 27.5.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Reka Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Zaje”, me fuqi 220 kw; “Turaj”, me fuqi 320 kw; “Xhaferaj-Meshteken”, me fuqi 3680 kw; “Novosej”, me fuqi 220 kw dhe “Kollovoz”, me fuqi 1500 kw (me fuqi totale 5940 kw).....	5781
Kërkesë e ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.2902, datë 6.6.2016	Për shpronësim për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan–Tepelenë (shtesa)”, për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “pyll”, “dru frutorë”.....	5782
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Kol Gjegja.....	5784

**VENDIM**

Nr. 414, datë, 1.6.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR
MBULIMIN E PJESSHËM TË
SHPENZIMEVE PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT “RINDËRTIMI I BANESËS
KU U NGRIT FLAMURI NË KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, në programin buxhetor (08220), “Trashëgimia kulturore dhe muzetë”, në zërin “Investime”, t’i shtohet fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për realizimin e projektit “Rindërtimi i banesës ku u ngrit Flamuri në Korçë”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi**UDHËZIM**

Nr. 14, datë 10.5.2016

**PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË
EMERGJENCËS NË INSTITUCIONET E
PËRKUJDESIT SHOQËROR TË
FINANCUARA NGA FONDET E
BUXHETIT TË SHTETIT PUBLIK QË
OFROJNË SHËRBIME TË
PËRKUJDESIT REZIDENCIAL PËR
FËMIJËT NË NEVOJË**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 5, të nenit 9, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në nenin 39, të ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 12.4.2012, “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.6.2012, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin në institucionet rezidenciale publike dhe private të përkujdesit shoqëror”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Institucionet e përkujdesit social rezidencial publik, të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit, ofrojnë shërbimin e emergjencës për një periudhë kohore prej 72 orësh për fëmijët e identifikuar që kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme.

2. Fëmijë që ka nevojë për mbrojtje të menjëhershme është fëmija, i cili nëse lihet në rrethanat aktuale pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë apo të jetë pre e keqtrajtimit të konsideruara vepër penale, sipas legjislacionit në fuqi. Fëmijë që kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme dhe që i ofrohet shërbimi i emergjencës në institucion përfshin:

a) Fëmijë i gjendur vetëm, i pashoqëruar në situatë rruge;



b) Fëmijë i neglizhuar, që jeton në rrethana që vendosin në rrezik jetën dhe shëndetin e fëmijës;

c) Fëmijë i abuzuar seksualisht nga personat në gjini apo kujdestari.

3. Fëmija që ka nevojë për mbrojtje të menjëhershme referohet në institucion nga njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, strukturat e policisë, shërbimi social shtetëror/rajonat.

4. Fëmija që ka nevojë për mbrojtje të menjëhershme vendoset në institucionin e përkujdesit shoqëror publik që ofron shërbime sociale për fëmijët, që ndodhet pranë vendbanimit/vendqëndrimit më të afërt me fëmijën. Dokumentacioni për vendosjen e fëmijës në institucion realizohet sipas procesverbalit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

5. Drejtuesit e institucioneve të përkujdesit social rezidencial për fëmijë marrin masa për garantimin e burimeve të nevojshme materiale dhe njerëzore për ofrimin e këtij shërbimi, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

6. Institucioni i përkujdesit social krijon kushtet e nevojshme për garantimin e plotësimin të nevojave bazë të fëmijëve, të cilëve u jepet shërbimi i emergjencës. Për shërbimin e emergjencës, institucioni ofron në mënyrë të menjëhershme: strehim, ushqim dhe kujdes shëndetësor. Një person përgjegjës është gjithmonë i pranishëm në institucion për ofrimin e këtij shërbimi.

7. Institucionet e përkujdesit social publik, brenda 12 orësh, bashkërendojnë punën me njësinë e mbrojtjes së fëmijëve për të ndërmarrë hapat e parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 12.4.2012, “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”.

8. Brenda 48 orësh nga marrja e njoftimit, njësia e mbrojtjes së fëmijëve i njofton zyrtarisht institucionit të përkujdesit social ku është akomoduar fëmija vendimin e grupit teknik multidisiplinar. Vendimi duhet të shprehë qartë nëse fëmija do të ribashkohet me familjen biologjike, do të marrë shërbim alternativ komunitar apo do të vijojnë procedurat për komisionimin e fëmijës në institucion përkujdesit social.

9. Në rastet kur vendimi i grupit teknik multidisiplinar parashikon ribashkimin e fëmijës me familjen biologjike apo shërbim alternativ komunitar, njësia e mbrojtjes së fëmijës vijon me monitorimin e situatës së fëmijës pranë familjes (biologjike ose kujdestare).

10. Në rastet kur vendimi i grupit teknik multidisiplinar parashikon komisionimin e fëmijës në institucion përkujdesit social, njësia e mbrojtjes së fëmijës përgatit dokumentacionin në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.6.2012, i ndryshuar, “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror” dhe e përcjell në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror, Agjencia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Institucionet e përkujdesit shoqëror rezidencial publik, të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit, dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi



PROCES - VERBAL

Në _____, më datë ____/____/____, unë _____, me detyrë _____, numër kontakti (cel) 06 _____, kryej referimin dhe dorëzimin e fëmijës Emer/Mbiemër _____, i datëlindjes _____._____, lindur në _____, dhe banues në _____ i pajisur me dokument identifikimi _____ (nëse ka) në shërbimin e emergjencës pranë institucionit të përkujdesit _____ shoqëror _____.

Referimi dhe dorëzimi i fëmijës së sipërpërmendur, në shërbimin e emrgjencës _____, adresa _____, e cila ofron shërbime emergjence dhe rezidenciale për këtë kategori fëmijësh kryesisht për arsye se:

- Nga verifikimet e deritanishme nuk është bërë e mundur gjetja, identifikimi dhe /ose konstatimi i prindërve/kujdestarëve ligjorë të fëmijës,
- Nga verifikimet e deritanishme rezulton se prindërit /kujdestarët ligjorë të fëmijës banojnë në një rreth të largët dhe mbërritja e tyre apo strukturave policore, të cilat do të kryejnë transferimin e fëmijës kërkon një kohë të konsiderueshme.
- Dyshohet se fëmija është i neglizhuar dhe jeton në rrethana që vendosin në rrezik jetën dhe shëndetin e fëmijës.
- Dyshohet se fëmija është i abuzuar seksualisht nga personat në gjini apo kujdestari.

Përshkrim i situatës së fëmijës në momentin e identifikimit si rast në rrezik:

Referuesi/ Dorëzuesi

Marrësi në Dorëzim

(Emër Mbiemër, firma)

(Emër Mbiemër, firma)

**VENDIM**

Nr. 67, datë 1.6.2016

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KËRKESAT MINIMALE TË
SIGURISË NË AMBIENTET KU KRYHEN
VEPRIMTARITË BANKARE DHE
FINANCIARE DHE PËR TRANSPORTIN
E VLERAVE MONETARE”**

Në mbështetje të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit, nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Sigurimit e Mbrojtjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë, në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4, datë 19.1.2011, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI
Genti Sejko**

RREGULLORE

**PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË
NË AMBIENTET KU KRYHEN
VEPRIMTARITË BANKARE DHE
FINANCIARE DHE PËR TRANSPORTIN E
VLERAVE MONETARE**

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale për sigurinë në ambientet në të cilat ushtrohen veprimtaritë bankare dhe/ose financiare, si dhe për transportin e vlerave monetare, me qëllim zhvillimin normal dhe në mënyrë të sigurt të këtyre veprimtarive.

**Neni 2
Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 70, pika 1, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të neneve 57, pika 2, 58 dhe 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Neni 3
Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja, zyrat e këmbimit valutor dhe subjektet financiare jobanka, që kryejnë veprimtari financiare me sportel dhe/ose me agjentë.

**Neni 4
Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Agjent” ka të njëjtin kuptim me termin e përkufizuar në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”.



b) “Sportel” quhet ndarja, e cila bën të mundur krijimin e një distance sigurie ndërmjet zonës së arkëtarëve dhe zonës së klientëve;

c) “Zona e arkëtarëve” është ambienti i subjektit, i cili shërben si vend pune i arkëtarëve;

d) “Zona e ruajtjes dhe administrimit të vlerave monetare” është zona, në brendësi të ambienteve në të cilën vendoset kasaforta;

e) “Siguri” është tërësia e masave që merren në mbrojtje të personelit, konsumatorëve, vlerave monetare, ambienteve dhe aktiveve të subjekteve të kësaj rregulloreje;

f) “Sisteme të mbrojtjes elektronike” janë sistemet elektronike të mbrojtjes nga zjarri, alarmit, akses kontrollit, monitorimit, skanimit, komunikimit etj.;

g) “Sigurimi i jashtëm” është shërbimi me personel sigurie që kryhet jashtë ambienteve të bankës ose degës së bankës së huaj;

h) “Sigurimi i brendshëm” është shërbimi me personel sigurie që kryhet brenda ambienteve të bankës ose degës së bankës së huaj me qëllim garantimin e sigurisë së bankës;

i) “ATM – (Automated Teller Machine)” është makineria, e cila kryen në mënyrë automatike tërheqje/depozitim të kartë-monedhave;

j) “SHPSF, Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike” është shoqëria e krijuar, licencuar dhe që funksionon sipas kërkesave të ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”;

k) “MZSH” është Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, i rregulluar sipas ligjit nr. 152, datë 21.12.2015, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”;

l) “Agjencitë ligjzbatuese” janë Policia e Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, prokuroritë, gjykatat, Drejtoria e Pastrimit të Parave dhe institucione të tjera të ngjashme;

m) “Banka” janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga banka e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU II

KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURINË DHE TRANSPORTIN E VLERAVE MONETARE NË BANKA

Neni 5

Procedura dhe struktura për sigurinë

1. Banka harton dhe miraton procedura për sigurinë e punonjësve, klientëve, vlerave monetare dhe aktiveve të saj.

2. Banka ka në strukturën e saj organizative një njësi të veçantë për sigurinë, e cila ka për detyrë:

a) planifikimin, hartimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e procedurave dhe masave për sigurinë;

b) implementimin e akteve ligjore dhe nënligjore të fushës së sigurisë, në aktet rregullative të bankës /degës të bankës së huaj;

c) koordinimin me agjencitë ligjzbatuese apo institucione të tjera, për çështje të sigurisë dhe emergjencave civile.

3. Në çdo degë dhe agjenci të bankës caktohet një punonjës, i cili krahas detyrave të tij, është përgjegjës edhe për zbatimin e procedurave dhe masave për sigurinë.

4. Banka rishikon në mënyrë periodike dhe përditëson procedurat dhe masat për sigurinë.

Neni 6

Kërkesa të përgjithshme për sigurinë në ambientet e bankës

1. Banka ushtron veprimtaritë në ambiente, të cilat plotësojnë minimalisht kërkesat e mëposhtme:

a) kanë hapësirat e nevojshme dhe kushte të përshtatshme për mirëmbajtjen e dokumentacionit, si dhe të vlerave monetare;

b) kanë miratimin nga shërbimet e MZSH-ve përkatëse për masat e marra ndaj zjarrit;

c) janë të arritshme nga njësitë e specializuara të sigurisë dhe transportit të vlerave monetare;

d) kanë qartësisht të ndara:

i) zonën e pritjes së klientit;

ii) zonën e arkëtarëve;

iii) zonën e ruajtjes së vlerave monetare fizike;

iv) zonën ku vendosen sistemet e teknologjisë dhe informacionit;

e) janë të pajisura me një burim të dytë dhe të vazhdueshëm të energjisë elektrike.



2. Banka lidh kontratën e sigurimit të vlerave monetare fizike me shoqërinë e sigurimit të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. Banka njofton strukturat përkatëse të Policisë Vendore për adresën ku do të hapet apo transferohet dega dhe/ose agjencia e saj.

4. Banka lidh kontratë me SHPSF-të, për:

i) marrjen dhe verifikimin e sinjalit të alarmit (licencë për nënkategorinë “I.3.A”);

ii) sigurimin e jashtëm dhe/ose të brendshëm (licencë e nënkategorisë “I.3.A”);

iii) transportin e vlerave monetare (licencë e nënkategorisë “I.3.B”).

5. Kontratat sipas pikës 4 të këtij neni duhet të kenë të specifikuar bankën, degën apo agjencinë, për të cilën lidhet kjo kontratë.

Neni 7

Kërkesa për zonën e arkëtarëve

1. Zona e arkëtarëve duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme për sigurinë:

a) të jetë e vendosur në një ambient të veçantë dhe të ndarë nga zonat e tjera nëpërmjet “Sportelit”;

b) të jetë e monitoruar me telekamera për secilin vend pune të arkëtarëve;

c) të ketë butona ose pedana alarmi në secilin vend pune të arkëtarëve;

d) të ketë minikasaforta ose sirtarë të posaçëm për mbajtjen e vlerave monetare fizike.

Neni 8

Kërkesa për zonën e ruajtjes dhe administrimit të vlerave monetare

1. Zona e ruajtjes dhe administrimit të vlerave monetare duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme për sigurinë:

a) të jetë në një vend të sigurt, plotësisht të ndarë nga zonat e tjera;

b) të kenë procedura të miratuara për lëvizjet në këtë zonë;

c) të ketë mbrojtje elektronike me:

i) sensorë sismikë;

ii) sensorë lëvizjeje;

iii) sensorë tymi.

d) të ketë sistem monitorimi me telekamera për:

i) hyrjen për në këtë zonë;

ii) ambientin e brendshëm.

Neni 9

Kërkesa për zonën ku vendosen sistemet e teknologjisë së informacionit

1. Sistemet e teknologjisë dhe të informacionit vendosen në një zonë të veçantë dhe në brendësi të ambienteve të bankës.

2. Zona ku vendosen sistemet e teknologjisë dhe të informacionit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme për sigurinë:

a) të jetë një zonë plotësisht e ndarë nga zonat e tjera;

b) të kenë procedura të miratuara për lëvizjet në këtë zonë;

c) të ketë mbrojtje elektronike, me:

i) sensorë lëvizjeje;

ii) sensorë tymi;

d) të ketë sistem monitorimi me telekamera, për:

i) hyrjen për në këtë zonë;

ii) ambientin e brendshëm të saj.

Neni 10

Kërkesat për mbrojtjen me anë të sistemeve elektronike

1. Banka merr masa për mbrojtjen me anë të sistemeve elektronike të ambienteve në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

2. Banka për sigurinë e ambienteve me anë të sistemeve elektronike, përveç përcaktimeve të neneve 7, 8 dhe 9, plotësojnë edhe kërkesat e mëposhtme:

a) kanë telekamera, të cilat filmojnë në mënyrë të pandërprerë:

i) sipërfaqet e jashtme të fasadës në hyrjen për në ambientin e brendshëm;

ii) zonën e qëndrimit të konsumatorëve;

iii) sportelin;

iv) veprimet në ATM;

v) rrugëkalimet dhe ambientet brenda bankës, ku kryhen procedurat e marrjes dhe dorëzimit të vlerave monetare.

b) kanë pajisje të veçantë dixhitale për regjistrimin e pamjeve, e cila:

i) vendoset në një ambient të sigurt, duke përjashtuar zonën e ruajtjes së vlerave monetare fizike;

ii) kohën e ruajtjes së regjistrimeve e ka jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.



c) kanë monitorim të zonave të bankës, në rastet kur nuk ka pamje të drejtpërdrejtë të tyre, në zyrën e:

- i) drejtuesit të degës/agjencisë; ose
- ii) përgjegjësit për sigurinë;

d) kanë mbrojtje elektronike me:

- i) sensorë lëvizjeje;
- ii) sensorë tymi;
- iii) sensorë të lagështirës;

iv) butona alarmi të montuar në zyrën e drejtuesit/përgjegjësit për sigurinë, të degës apo agjencisë;

v) sirenë alarmi e brendshme ose e jashtme;

e) sisteme për transmetimin e sinjalit të alarmit, të paktën në një nga qendrat e kontrollit në:

- i) strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit;
- ii) SHPSF-së me të cilën ka kontratë;
- iii) njësinë e sigurisë të vetë bankës.

3. Implementimi, përpunimi, administrimi dhe ruajtja e të dhënave të përfituara nga sistemet e mbrojtjes elektronike, bëhet në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Procedurat për implementimin, administrimin dhe funksionimin e sistemeve të sigurisë, ndiqen në vijimësi nga njësia për sigurinë në Bankë, përcaktuar në nenin 5, pika 2, të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Kërkesat për mbrojtjen me personel sigurie

1. Bankat marrin masa për sigurimin e brendshëm gjatë orarit të punës, të ambienteve në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre me punonjës të certifikuar sipas ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

2. Përfshihen nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni agjencitë bankare, marrja e masave për të cilat vlerësohet nga vetë banka, në varësi të nivelit të rrezikut të perceptuar.

3. Bankat në vlerësimin e tyre, mund të marrin edhe masa për sigurimin e jashtëm të ambienteve në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre, gjatë dhe pas orarit të punës, në varësi të nivelit të rrezikut të perceptuar. Edhe në këtë rast, masat e sigurimit kryhen me punonjës të certifikuar sipas ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

Neni 12

Kërkesat për transportin e vlerave monetare

1. Bankat marrin masat e nevojshme për transportimin në mënyrë të sigurt të vlerave monetare.

2. Transporti i vlerave monetare realizohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 75/2014 datë 10.7.2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, si edhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

3. Transporti i vlerave monetare realizohet me punonjës shërbimi të SHPSF-së, me licencë të kategorisë “I.3.B”.

KREU III

KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË NË AMBIENTET E ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR, SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA QË KRYEJNË VEPRIMTARI ME SPORTELE DHE/OSE ME AGJENTË

Neni 13

Kërkesa për sigurinë e ambienteve

1. Zyrat e këmbimit valutor, institucionet financiare jobanka që kryejnë veprimtarinë me sportel dhe/ose me agjentë, ushtrojnë veprimtarinë në ambiente që plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) janë të arritshme nga njësitë e specializuara për sigurinë;

b) kanë hapësirat e nevojshme dhe kushte të përshtatshme për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe vlerave monetare;

c) kanë qartësisht të ndara zonat e mëposhtme:

i) zona e pritjes së klientit;

ii) zona e arkëtarëve;

d) zona e arkëtarëve plotëson kushtet e mëposhtme:

i) është e vendosur në një ambient të veçantë dhe të kufizuar nga zonat e tjera me “Sportel”;

ii) vlerat monetare mbahen të vendosura në minikasaforta;

iii) është e monitoruar me telekamera.

2. Zyrat e këmbimit valutor dhe institucionet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare në qendra biznesi/tregtare, përfshihen nga zbatimi i nënpikës “i” të shkronjës “c” në pikën 1 të këtij neni.

3. Zyrat e këmbimit valutor, subjektet e tjera financiare jobanka që kryejnë veprimtari financiare



me sportel, në ambientet ku zhvillojnë veprimtarinë financiare, kanë sistem monitorimi, i cili përbëhet nga:

a) telekamerat, të cilat filmojnë në mënyrë të pandërprerë të gjitha ambientet e subjektit;

b) pajisje dixhitale për regjistrimin e pamjeve, e cila:

i) vendoset brenda zonës së arkëtarëve; dhe

ii) kohën e ruajtjes së regjistrimeve e ka jo më pak se 5 (pesë) ditë.

4. Implementimi, përpunimi, administrimi dhe ruajtja e të dhënave të përfituara nga sistemet e mbrojtjes elektronike bëhet në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

5. Zyrat e këmbimit valutor dhe institucionet financiare jobanka që kryejnë veprimtarinë me sportel dhe/ose me agjentë, njoftojnë strukturat përkatëse të Policisë Vendore, për adresën ku do të hapen apo transferohen zyrat ose agjentët e tyre.

6. Subjektet financiare jobanka që kryejnë veprimtari me sportel dhe/ose me agjentë, janë përgjegjës për verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nga këta të fundit.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14 Mbikëqyrja

1. Banka, çdo vit dhe sa herë ka ndryshime, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë (Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes), një kopje të dokumentacionit për:

a) kontratat e lidhura me SHPSF-të, për:

i) marrjen dhe verifikimin e sinjalit të alarmit,

ii) sigurimin e jashtëm ose të brendshëm,

iii) transportin e vlerave monetare;

b) licencat (fotokopje) e nënkategorisë “I.3.A” dhe “I.3.B” të SHPSF-ve me të cilat kanë lidhur kontratë;

c) listën e automjeteve të blinduara për transportin e vlerave monetare ku të evidentohen:

i) targa dhe tipi i automjeteve;

ii) të dhënat për drejtuesin e automjetit;

iii) kopje të autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

d) listën e punonjësve të ngarkuar për kryerjen e

veprimeve me vlerat monetare së bashku me certifikatat përkatëse.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje, njoftojnë Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, në rast të hapjes dhe/ose ndryshimeve të vendndodhjes së ambienteve ku zhvillojnë veprimtarinë e tyre.

3. Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, pas marrjes së njoftimit sipas pikës 2 të këtij neni, kërkon nga Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes të Bankës së Shqipërisë, kryerjen e inspektimit të ambienteve lidhur me plotësimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

4. Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, për zbatimin e kërkesave të nenit 5 të kësaj rregulloreje, mund të kërkojë në çdo kohë kryerjen e inspektimeve tek subjektet e kësaj rregulloreje nga Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes së Bankës së Shqipërisë.

Neni 15

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 63, datë 27.5.2016

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E “RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE NGA OPERATORËT E TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË LICENCUARVE QË MBARTIN DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “e”, 60, pika 9 dhe 75, pika 8, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr.



21, datë 18.3.2009, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin për “Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të licencuarit që mbartin detyrimin e shërbimit publik”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregulloreve të procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të licencuarit që mbartin detyrimin e shërbimit publik”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumentit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 64, datë 27.5.2016

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT

Në mbështetje të nenit 16, nenit 21 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015n “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin e “Draftmetodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “Draftmetodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumentit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 65, datë 27.5.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 16; 47; 83 dhe 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Pas miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për “kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” me nr. 244, datë 30.3.2016, ERE në zbatim të nenit 14, pika 2, të këtij vendimi ngarkohet me detyrimin e miratimit të kësaj rregulloreje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregulloreve për vendosjen e detyrimit të shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri”.



2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 66, datë 27.5.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË”

Në mbështetje të nenit 16; nenit 79 dhe 94 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin e “Draftkushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 67, datë 27.5.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES MBI PROCEDURAT PËR PARAQITJEN E NJË KËRKESË, SHQYRTIMIN E SAJ DHE AFATET E NJOFTIMIT KUR KLIENTI DYSHON NË SAKTËSINË E TË DHËNAVE TË APARATIT MATËS TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16; 77, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin e “Draftrregullores mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “Rregullores mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 68, datë 27.5.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË “RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16; 81, pika 2, 99 dhe 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin



e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me “Miratimin e një ndryshimi në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Në datën 30.3.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Në nenin 99, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se: “Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.”.

- Në nenin 14, pika 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, është parashikuar se: “Këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e një ndryshimi në “Rregullat e tregut” miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, si më poshtë:

Në kapitullin IX, pika 1.3, germa “g”, ndryshon përmbajtja si më poshtë:

a) “Duke filluar nga 1 korriku 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, me përjashtim të subjekteve të përcaktuar në ligjin nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme dhe sipas

pikës 4, të nenit 99, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

b) Klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal nuk janë përgjegjës për disbalancat kundrejt këtij të fundit.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a. dhe palët e tjera të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 69, datë 27.5.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2016, PËR KOMPANINË OST SHA

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, germat “a” dhe “e”; neni 60, pika 4 dhe 5; nenit 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25, të “rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016 për kompaninë OST sh.a., të përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016, për kompaninë OST sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM**

Nr. 70, datë 27.5.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2016, PËR
KOMPANINË OSHEE SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germat “a” dhe “e”; 75; 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin “Për fillimin e procedurave për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016, për kompaninë OSHEE sh.a., të përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin planit të investimeve për vitin 2016, për kompaninë OSHEE sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 71, datë 27.5.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË KESH
SHA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR PERIU DHËN 1 KORRIK
2016–31 DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 21, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 18; 20 dhe 21, të “Rregullave të praktikës

dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 77, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe e Tarifave,

konstatoi se:

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 72, datë 27.5.2016**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OSHEE
SHA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR
SHËRBIMIN E SHPËRNDARJES DHE
ÇMIMIT TË SHITJES ME PAKICË TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL
PËR PERIU DHËN 1 KORRIK–31
DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 18, 20 dhe 21, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, si dhe të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shitjes me pakicë për klientët tariforë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga furnizuesi i shërbimit universal për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016,

konstatoi se:

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga furnizuesi i shërbimit universal për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës për shërbimin e shpërndarjes dhe çmimit të shitjes

me pakicë të energjisë elektrike nga furnizuesi i shërbimit universal për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a. për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 73, datë 27.5.2016**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “REKA
ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-et “ZAJE”, ME
FUQI 220 kw; “TURAJ”, ME FUQI 320 kw;
“XHAFERAJ-MESHTEKEN”, ME FUQI
3680 kw; “NOVOSEJ”, ME FUQI 220 kw
DHE “KOLLOVOZ”, ME FUQI 1500 kw
(ME FUQI TOTALE 5940 kw)**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Reka Energy sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për licencimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Reka Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.3; 4.1.4, germat “a”, “b” dhe “c”; 4.1.5, germat “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Bilancin financiar; vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe dokumentet që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, germat “a”, “b” dhe “c”);

- Të dhënat teknike për secilin HEC; të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin dhe miratimi i pikës së lidhjes (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4, germa “d” dhe 4.1.5, germa “a”), do të njoftohet subjekti, që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Reka Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Zaje”, me fuqi 220 kw; “Turaj”, me fuqi 320 kw; “Xhaferaj-Meshteken”, me fuqi 3680 kw; “Novosej”, me fuqi 220 kw; “Kollovoz”, me fuqi 1500 kw (me fuqi totale 5940 kw).

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 2902, datë 6.6.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën, “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan–Tepelenë (shitesa)”, për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “pyll”, “dru frutorë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “pyll”, “dru frutorë”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 4 596 563 (katër milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUTURËS
Eduart Seitaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Levan-Tepelenë (shitesa)”

Fshatrat: Iliras dhe Qesarat

	Emër	Atësi	Mbiemër	Z.K	Nr.pas	Sip. Total e	Sip.s hpr. Arë (m ²)	Sip.S hpr.P yll (m ²)	Sip.s hpr. Trual (m ²)	Çmimi VKM nr.514, 30.07.2014	Vlera	Barrë hipotekore	Shënime
1	Xhelil	Belul	Muka	3111	14/6	2200	1115			112	124,880	Nuk ka	Konf.ZVRPP
2	Myslym		Lika	3111	14/22	2475	1278			112	143,136	Nuk ka	Konf.ZVRPP
3	Shyqo	Hysen	Zeçaj	3111	37/1	1030	56			112	6,272	Nuk ka	Konf.ZVRPP
4	Dashamir	Veip	Kasa	3111	51/11	584	182			112	20,384	Nuk ka	Konf.ZVRPP
5	Axhem	Jazo	Meta	3111	145/1	500			142	125	17,750	Nuk ka	Konf.ZVRPP
6	Reit	Yzeir	Zeçaj	3111	145/2	1100	490			112	54,880	Nuk ka	Konf.ZVRPP
7	Reit	Yzeir	Zeçaj	3111	145/4	500	343			112	16,016	Nuk ka	Konf.ZVRPP
8	Shefqet	Gani	Sina	3111	145/5	1000	343			112	38,416	Nuk ka	Konf.ZVRPP
9	Agim	Reit	Zeçaj	3111	145/3	500	205			112	22,960	Nuk ka	Konf.ZVRPP
10	Gezim	Shaban	Shehu	3111	145/6	1500	642			112	71,904	Nuk ka	Konf.ZVRPP
11	Qazim	Velisha	Velika	3111	145/8	700	309			112	34,608	Nuk ka	Konf.ZVRPP
12	Bashkim	Hajri	Alicani	3111	145/9	700	315			112	35,280	Nuk ka	Konf.ZVRPP
13	Petrit	Jazo	Meta	3111	145/10	800	230			112	25,760	Nuk ka	Konf.ZVRPP
14	Qemal	Jaho	Jaupi	3111	145/25	550	3			112	336	Nuk ka	Nuk ndodhet ne harte
15	Astrit		Meta	3111	145/11	500	158			112	17,696	Nuk ka	Konf.ZVRPP
16	Xhelil	Belul	Mukaj	3111	145/12	450	119			112	13,328	Nuk ka	Konf.ZVRPP
17	Dalip	Shyqo	Meta	3111	145/13	1000	291			112	32,592	Nuk ka	Konf.ZVRPP
18	Shefit	Shyqo	Meta	3111	145/14	500	164			112	18,368	Nuk ka	Konf.ZVRPP
19	Halim	Sulo	Mema	3111	145/15	400	270			112	30,240	Nuk ka	Konf.ZVRPP
20	Sulo	Mehmet	Meta	3111	145/16	1100	368			112	41,216	Nuk ka	Konf.ZVRPP
21	Veli	Yzeir	Zeçaj	3111	145/24	1100	279			112	31,248	Nuk ka	Konf.ZVRPP
22	Hysen	Muharrem	Zeçaj	3111	145/18	2200	791			112	88,592	Nuk ka	Konf.ZVRPP
23	Arif	Xhaferr	Lala	1980	153/4	7600	784			112	87,808	Nuk ka	Konf.ZVRPP
24	Shahin		Hodo	1980	82	2200	323			112	36,176	Nuk ka	Konf.ZVRPP
25	Bashkim		Bara	1980	174	2600	689			112	77,168	Nuk ka	Konf.ZVRPP
26	Ibrahim,Defrim Veizaj			1980	175/2	23260		21638		100	2,163,800	Nuk ka	Konf.ZVRPP
27	Arif	Xhaferr	Lala	1980	186/4	300	13			112	1,456	Nuk ka	Konf.ZVRPP
28	Demir	Male	Goga	1980	189/48	1900	10			112	1,120	Nuk ka	Konf.ZVRPP
29	Eduart	Zano	Kalemi	1980	189/50	1300	30			112	3,360	Nuk ka	Konf.ZVRPP
30	Reit	Haki	Kalemi	1980	189/52	1400	21			112	2,352	Nuk ka	Konf.ZVRPP
31	Metush	Haki	Kalemi	1980	189/53	1500	47			112	5,264	Nuk ka	Konf.ZVRPP
32	Reshat	Haki	Kalemi	1980	189/54	800	64			112	7,168	Nuk ka	Konf.ZVRPP
33	Zini	Zeço	Kamberi	1980	189/57	1000	50			112	5,600	Nuk ka	Konf.ZVRPP
34	I paidentifikuar			1980	189/100	2000	92			112	10,304	Nuk ka	Konf.ZVRPP
35	Engjell	Qerim	Kamberi	1980	189/60	700	51			112	5,712	Nuk ka	Konf.ZVRPP
36	Bashkepronesi		Manaj	1980	189/61	1800	70			112	7,840	Nuk ka	Konf.ZVRPP
37	Alush	Feta	Kamberi	1980	189/64	1000	16			112	1,792	Nuk ka	Konf.ZVRPP
38	Agim	Nuri	Kamberi	1980	189/76	1000	70			112	7,840	Nuk ka	Konf.ZVRPP
39	Rabian,Bako	Meto	Hysetoci	1980	206/47	300			157	125	19,625	Nuk ka	Konf.ZVRPP
40	Xhemal	Feta	Kamberi	1980	214/32	600	106			112	11,872	Nuk ka	Konf.ZVRPP
41	Qemal	Demir	Goga	1980	214/28	1000	41			112	4,592	Nuk ka	Konf.ZVRPP
42	Bashkim		Lolaj	1980	214/47	1000	23			112	2,576	Nuk ka	Konf.ZVRPP
43	Myzafer		Lolaj	1980	214/26	700	30			112	3,360	Nuk ka	Konf.ZVRPP
44	Shuaip		Lolaj	1980	214/25	800	34			112	3,808	Nuk ka	Konf.ZVRPP
45	Muharrem		Lolaj	1980	214/24	800	39			112	4,368	Nuk ka	Konf.ZVRPP
46	Zini	Shaqo	Kamberi	1980	214/22	300	34			112	3,808	Nuk ka	Konf.ZVRPP
47	Bashkepronesi			1980	214/46	1600	45			112	5,040	Nuk ka	Konf.ZVRPP
48	Belul		Caushi	1980	214/33	600	72			112	8,064	Nuk ka	Konf.ZVRPP
49	Rexhep	Bekdash	Kamberi	1980	214/1	2000	2			112	224	Nuk ka	Konf.ZVRPP
50	Bashkepronesi			1980	217/28	2100	155			112	17,360	Nuk ka	Nuk ndodhet ne harte
51	Bashkim		Velikaj	1980	217/9	1120	161			112	18,032	Nuk ka	Konf.ZVRPP
52	I paidentifikuar			1980	189/51		16			112	1,792		
TOTALI											3,415,143		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Levan-Tepelenë (shtesa)”
Fshati: Iliras

	Emër	Atësi	Mbiemër	Z.K	Nr.pas	Kulturat bujqësore Vlera në lekë	Dru Frutoret Vlera në lekë	Barrë hipotekore	Shënime
1	Agim	Reit	Zeçaj	1980	150,153/5		938940	Nuk ka	konf.nga ZVRPP per token me qera 99 vjet
	Totali						938940		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Levan-Tepelenë”
(Pas ndryshimit të VKM Nr. 538 datë 13.06.2013)

NDRYSHIMI I VKM Nr.538, date 13.06.2013											
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Z.K	Nr.Pas	Sip. Totale	Sip. Arë(m ²)	Cmimi VKM nr.514, 30.07.2014	Vlera	Barrë hipotekore	Shënime
1	Levend	Refat	Manaj	1980	214/20	500	72	112	8,064	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
2	Hodo		Serjani	1980	214/17	800	83	112	9,296	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
3	Bashkepronesi		Caushi	1980	214/15	800	52	112	5,824	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
4	Beqir	Hazbi	Velikaj	1980	214/14	1000	81	112	9,072	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
5	Ylli	Hazbi	Velikaj	1980	214/51	800	49	112	5,488	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
6	Myftar	Hazbi	Velikaj	1980	214/12	800	76	112	8,512	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
7	Guri	Yzeir	Lalaj	1980	214/11	1000	80	112	8,960	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
8	Eqerem	Hekuran	Serjani	1980	214/10	600	56	112	6,272	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
9	Muharrem	Xhelo	Selmani	1980	214/8	600	77	112	8,624	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
10	Metush	Haki	Kalemi	1980	214/6	1000	71	112	7,952	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
11	Skender	Bektash	Kamberi	1980	214/42	1300	88	112	9,856	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
12	Myfit	Dervish	Manaj	1980	214/3	1000	92	112	10,304	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
13	Cerciz		Manaj	1980	217/3	600	81	112	9,072	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
14	Ferdinant	Qazim	Baraj	1980	217/5	900	220	112	24,640	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
15	Andon	Qazim	Baraj	1980	217/6	1100	340	112	38,080	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
16	Tahir	Selam	Lumani	1980	217/14	1500	154	112	17,248	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
17	Leonidha	Myrtezan	Kalemi	1980	217/15	1200	237	112	26,544	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
18	Remzi	Teme	Manaj	1980	217/16	1300	256	112	28,672	Nuk ka	Konfirmuar ZVRPP
	TOTALI								242,480		

KËRKESË

Shtetasja Dorina Gjegja, e bija e Kolës dhe e Marijes, e datëlindjes 14.8.1983, banuese ne Durrës, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të vdekur të babait të saj,

shtetasit Kol Gjegja, i datëlindjes 8.2.1955, në datën 13.12.1994.

KËRKUES
Dorina Gjegja

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë